

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist I (Informacioni), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Burimeve Njerëzore (Kategoria III-b).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i një gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist I (Informacion) ka për detyrë si më poshtë:

Specialist i Informacionit është në varësi të Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe kryen këto detyra:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Mbulon veprimtarinë administrative për funksionimin optimal të ofrimit të shërbimit ndaj publikut në lidhje me kërkesa për takime, ankesa;
3. Pret dhe informon qytetarët;
4. Rregjistron ankesat e qytetarëve;
5. Identifikon shqetësimet e qytetarëve dhe bashkërendon punën me strukturat e tjera administrative në institucion, për sqarimin dhe zgjidhjen e tyre;
6. Rezervon takime të qytetarëve me Drejtorët e institucionit dhe me Kryeinspektorin e IMT;

7. Vepron në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit;
8. Koordinon përgjigjen zyrtar ndaj kërkesave për informacion ose ankesave të depozituara dhe evidenton në vazhdimësi ankesat dhe problemet e bëra prezente nga të gjithë subjektet e interesuara dhe ndjek zbatimin e procedurave administrative përkatëse për sqarimin dhe dhënien e përgjigjes për çdo kërkesë.

Dokumentat që aplikanti për Specialist I (Informacioni), në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Burimeve Njerëzore, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit të përcillet njehsimi nga MAS*) ;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 20.09.2024 **ora** 14.00.